



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1118/3 prot.

Tiranë, më 30. 10. 2020

V E N D I M

Nr. 155, Datë 30. 10. 2020

Bazuar në informacionin e publikuar në media¹ dhe në rrjetet sociale², Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32/1/c të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: “*Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji*”, nenin 41/2/a të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: “*Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara*”, me Urdhrin nr. 95, datë 30.07.2020 filloi procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes lidhur me gjuhën e përdorur, në programin, Reality Show “REAL TALK me Aventurierët-V.” të datës 24.07.2020 të publikuar në faqen web të televizionit Top-Channel.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të administruar, një nga protagonistet e programit, Reality Show “REAL TALK me Aventurierët-V.” të datës 24.07.2020 (Vali), ka përdorur shprehjen: “... o djalë je shumë down³”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore,*

¹ <https://top-channel.tv/video/real-talk-me-aventurieret-vali/>

² https://www.instagram.com/p/CC_OoFhj8o7/?fbclid=IwAR2OYoghrijPFdnyJW38EAkIIm28FE6MS5cGTfwoMI4X71YJvnNEKL4ZyB8c

³ Referuar shprehjes së përdorur në sekondën 10-12 të videos.

përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të Ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1118/1, datë 30.07.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe ka kërkuar parashtrime me shkrim nga televizioni Top Channel, lidhur me gjuhën e përdorur në programin, Reality Show “REAL TALK me Aventurierët-V.” të datës 24.07.2020 (V.). Në këtë shkresë, Komisioneri ka informuar televizionin Top Channel se do të vlerësonte pozitivisht faktin, nëse nga ana e televizionit Top-Channel dhe redaksisë së programit “Aventurierët” do të ndërmerreshin masa të menjëhershme duke kërkuar ndjesë publike dhe fshirjen nga publikimi të shprehjes së përdorur, në mënyrë që situata diskriminuese të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen.
2. Duke qënë se televizioni Top Channel nuk kishte vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë përgjigje, me anë të shkresës nr. 1118/2, datë 10.09.2020, Komisioneri i dërgoi një kujtesë lidhur me shkresën nr. 1118/1, datë 30.07.2020.

Pavarësisht kërkesave të sipërcituara për të cilat televizioni Top Channel ka marrë dijeni⁵, nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion lidhur me parashtrimet e kërkuara.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje objekt i ankesës dhe që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁵ Referuar Lajmërim Marrje të Postës Shqiptare: RR411950912AA për shkresën Nr. 1118/1, dhe RR461451305AA për shkresën Nr. 1118/2.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Sipas informacionit të administruar gjatë procedurës së hetimit, u konstatua që:

- Sipas informacionit të administruar të publikuar në media⁶ dhe në rrjetet sociale⁷, në programin Reality Show “REAL TALK me Aventurierët-V.” të datës 24.07.2020, një nga protagonistet e programit (V.), në pjesën prezantuese/hyrëse të emisionit shfaqet duke biseduar në celular me një djalë dhe mes tyre zhvillohet dialogu si më poshtë: “*Të thashë që nuk mundem sot, o djalë je shumë down⁸, nuk mundem pra, herë tjetër do takohemi normalisht, ok mjeshtër*”.
- Pavarësisht kërkesave të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të dhënë shpjegimet e tij lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë, nga ana e televizionit Top Channel nuk u vu në dispozicion asnjë informacion apo argument lidhur me shprehjen e përdorur në adresë të personave me sindromën Down.

Aftësia e Kufizuar, është shkak për të cilin Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*” dhe bazuar në nenin 32/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me aftësinë e kufizuar.

Ligji 10221/2010 ka parashikuar në Nenin 7/1 se: “*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”.

⁶ <https://top-channel.tv/video/real-talk-me-aventurieret-vali/>

⁷ https://www.instagram.com/p/CC_OoFhj8o7/?fbclid=IwAR2OYoghrijPFDnyJW38EAKIIm28FE6MS5cGTfwoMI4X71YJvnNEKL4ZyB8c

⁸ Referuar shprehjes së përdorur në sekondën 10-12 të videos.

Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë në bazat e shtetit shqiptar. Kjo sanksionohet në nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet se: *“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”*.

Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cënojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos cënimin e tyre nga privatët, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për ti mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat të Njeriut dhe Lirive Themelore, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, kanë fuqinë e Konventës.

“Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, e ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin nr. 108/2012, datë 15.11.2012, ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t’u sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Parimi i mosdiskriminimit është një ndër parimet kryesore të kësaj Konvente. Në kuptim të kësaj Konvente, personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë⁹.

Në nenin Neni 1 të konventës përcaktohet se: *“Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektimin e dinjitetit të tyre të lindur”*. Ndërsa në nenin 8 përcaktohet se: *“Rritja e ndërgjegjësimit. 1. Shtetet Palë marrin përsipër të aprovojnë masat e duhura, efektive dhe të menjëhershme: (b) Për të luftuar stereotipat, paragjykimet dhe praktikat e dëmshme lidhur me personat me aftësi të kufizuar, përfshirë dhe ato me bazë seksin dhe moshën në të gjitha fushat e jetës; 2. Masat për këtë qëllim përfshijnë: Inkurajimin e të gjitha organeve të medias për të*

⁹ Konventa mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe Protokollin Opsional, Neni 1.

portretizuar personat me aftësi të kufizuar në mënyrë të tillë që të jetë në pajtim me këtë Konventë”.

Sipas Rekomandimit të Përgjithshëm të Politikave nr. 15 të Komisionit European kundër Racizmit dhe Intolerancës për *“Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”*, gjuha e urrejtjes, sipas formulimit, do të kuptohet si mbrojtje, promovim ose nxitje, në çdo formë, e denigrimit, urrejtjes ose shpifjes ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmimi, ofendimi, stereotipizimi negativ, stigmatizimi ose kërcënimi në lidhje me këtë person apo grup personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes, bazuar në *“racë”*, ngjyrë, prejardhje, origjinë kombëtare ose etnike, moshë, aftësi të kufizuar, gjuhë, fe ose besim, seks, gjini, identitet gjinor, orientim seksual dhe karakteristika të tjera personale ose statuse.

Në parimin 6, të Shtojcës së Rekomandimit nr. (97) 20, *“Të Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare për “Gjuhën e Urrejtjes”*, theksohet se ligji dhe praktika kombëtare duhet të dallojë qartë përgjegjësinë e autorëve të shprehjeve të gjuhës së urrejtjes në njërën anë dhe përgjegjësinë e medias, të cilët kontribuojnë në përhapjen, si pjesë e misionit të tyre për të komunikuar informacionin dhe emisione në çështje të interesit publik, në anën tjetër. Por, në pjesën shpjeguese të rekomandimit theksohet se, kjo nuk do të thotë që mediat nuk duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur kur transmetojnë mbi gjuhën e urrejtjes ose mungesës së tolerancës në përgjithësi. Faktet eidentojnë se produksioni i programit, Reality Show *“REAL TALK me Aventurierët-V.”* dhe televizioni Top Channel kanë patur mundësinë që në transmetimin dhe publikimin e programit në rrjetet sociale, mund të evitonin përsëritjen e shprehjes së përdorur nga protagonistja e emisionit.

Në këtë kuptim, *“gjuha e urrejtjes”* kundër personave me sindromë down, ka të bëjë me të gjitha format e shprehjes, të përhapura si nëpërmjet medias, ashtu edhe nëpërmjet internetit, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, stereotipizim negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj personave me aftësi të kufizuara. Vlerësimi nëse shprehje të caktuara do të konsiderohen si *“gjuhë e urrejtjes”*, duhet të bëhet në përputhje me lirinë e shprehjes të garantuar në nenin 10 të Konventës.¹⁰

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë mbron njëkohësisht lirinë e shprehjes në nenin 22 të saj ku parashikohet se: *“Liria e shprehjes është e garantuar”*. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Kështu, në nenin 17, të saj sanksionohet se: *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara*

¹⁰ KEDNJ në nenin 10 parashikon se: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes”*. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor

në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2.Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Shohim se, Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për këtë arsye, në analizën që i është bërë shprehjes së përdorur në emision, nëse ajo do të konsiderohet në tejkalim të lirisë së fjalës të sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës, KMD i referohet kufizimeve që parashikon Konventa për lirinë e shprehjes, të parashikuar në nenin 10 të saj dhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar në gjykime të ndryshme se: *“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)”. Sa më sipër lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.*

Në çështjen në fjalë, Komisioneri mban parasysh faktin e rëndësishëm që emisioni “Reality Show “REAL TALK me Aventurierët”¹¹, i cili transmetohet çdo ditë të premte, në orën 22.30, që nga data 03 prill, është një program i ndjekur nga shumë teleshikues dhe ndjekës të rrjeteve sociale dhe pjesëmarrësit për shkak të shikueshmërisë janë persona publikë si dhe televizioni “Top Channel” është një televizion i ndjekur në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Rëndësia që merr liria e fjalës për personat publikë sjell dhe një përgjegjësi më të madhe, për të treguar më tepër kujdes dhe për të evituar gjuhën që nxit mos tolerancën dhe diskriminimin mes publikut. Lufta kundër mungesës së tolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se, përhapja e veprimeve të tilla nëpërmjet medias vizive përbën një mjet të fuqishëm të përhapjes së informacionit.

¹¹ Programi Aventurierët është formati më i ri i Reality Show-t në Shqipëri, i cili shfaqet në disa rrjete sociale si: facebook, instagram, tiktok, youtube, etj.

Shprehja e përdorur në emision, në adresë të personave me sindromën down, krijon në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirë informuar në lidhje me personat që janë me sindromën down, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, e tek disa ndjenja urrejtje ndaj këtyre personave të cilët në mënyrë të veçantë kanë nevojë që të socializohen dhe jo të ndjehen të veçuar.

Mosdiskriminimi është e drejtë kushtetuese e sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,¹² gjithashtu Shqipëria ka nënshkruar njëkohësisht Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat të Njeriut dhe Lirive Themelore, e cila në nenin 14, sanksionon se: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”, si dhe Protokollin Nr. 12 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore¹³, i cili i detyron shtetet anëtare që e kanë ratifikuar, të garantojnë gëzimin pa diskriminim të të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3, pika 1 dhe 2, jep këto përkufizime: ***“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”***

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në çështjen e firmës Feryn¹⁴, ka mbajtur qëndrimin dhe ka pranuar se diskriminimi i drejtpërdrejtë mund të shfaqet edhe në ato raste kur nuk mund të identifikohet ankuesi. Për rrjedhojë duke mos patur nevojë për një viktimë, nuk lind nevoja as për të identifikuar një krahasues.

Komisioneri vlerëson se shprehja e përdorur në emision, duke përdorur fjalën “down” me qëllim ofendimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë mund të prodhojë përhapjen ose nxitjen e stereotipizimeve negative, stigmatizimeve ose kërcënimeve kundër fëmijëve dhe të rriturve të diagnostifikuar me “sindromën down”.

¹² Ne nenin 18 Kushtetuta parashikon “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.”.

¹³ E ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

¹⁴ Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding v. Firma Feryn NY (Case C-54/07).

Komisioneri vlerëson se shprehja e përdorur në emisionin objekt shqyrtimi është një rast i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Trajtimi dinjitoz, pa diskriminim dhe respektimi i personave me aftësi të kufizuara është i përcaktuar saktësisht dhe në mënyrë të detajuar dhe në Seksionin 6 të Kodit të Transmetimit për Median Audiovizive të miratuar me Vendimin nr. 228, datë 11.12.2017 të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Në parimet themelare të këtij Kodi në pikën 1.3 dhe 1.5 përcaktohet se: “1.3. *Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut*” ndërsa në pikën 1.5 përcaktohet se: “*Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve*”.

Toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si një çështje parimi mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës¹⁵. E drejta e individëve, për të shprehur lirisht mendimet e tyre nuk duhet të “fyejë, trondit apo shqetësojnë” të tjerët¹⁶.

Në nenin 3/5 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “*“Shqetësim” është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë*”.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se debati i shëndoshë e i hapur në një shoqëri pluraliste nuk mund të arrihet pa ruajtje të fortë dhe të gjithanshme të së drejtës së lirisë së shprehjes duke patur parasysh gjithmonë ndalimin e të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë, përçmojnë apo denigrojnë një komunitet apo përkatësi të caktuar. Sipas standardeve përkatëse të Këshillit të Evropës, edhe kufizimet nga e drejta synojnë ti shërbejnë interesit më të mirë të një shoqërie demokratike dhe pluraliste.

Sa më sipër papërgjegjshmëria e lirisë së fjalës e përdorur në emisionin “Reality Show “REAL TALK me Aventurierët”, cënon dinjitetin dhe personalitetin e personave që vuajnë nga sindroma down për shkak të aftësisë së kufizuar. Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se shprehja e përdorur në emisionin “Reality Show “REAL TALK

¹⁵ Çështja Erbakan kundër Turqisë, 6 korrik 2006, GJEDNJ.

¹⁶ Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, çështja nr. 5493/72, 07 dhjetor 1976.

me Aventurierët”, datë 24.07.2020 në televizionin Top Channel, ka vënë në pozita diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar, personat që vuajnë nga sindroma down në formën e shqetësimit.

Gjatë aktivitetit të tij, Komisioneri ka dënuar fuqimisht përdorimin e gjuhës fyese dhe intolerancës ndaj një komuniteti të caktuar, nga ana e individëve që bëjnë pjesë në jetën publike. Gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, si masë rregulluese ndjesë publike në mënyrë që situata diskriminuese e pretenduar të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 92, pika 2 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 32, pika 1, gërma a) si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasve me sindromën down, në formën e shqetësimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e televizionit Top Channel.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, televizioni Top Channel, të dalë me një deklaratë publike (verbale apo të shkruar) me anë të së cilës të distancohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë e cila paragjykon haptazi, cënon dhe prek dinjitetin e personave me sindromën down.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, televizioni Top Channel, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)